



Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.III

Deçan, dt.27.04.2021

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-së, me dt.27.04.2021.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, drejtori i Buxhetit-Agron Demukaj, Drejtori Urbanizmit-Ramë Melaj, drejtori Administrates-Jashar Dobraj Zyrtarja për informim-Yllarta Thaqi, Kryeshefi Ekzekutiv i Ndermarrjes "Higjiena"-Kastriot Hulaj.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes "Higjiena";
3. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën Janar-Mars 2021;
4. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Njësinë e administrimit të dokumenteve dhe punën në zyre;
5. Shpallja me interes e Hapësirave Zhvillimore në Parkun Kombëtar në Komunën e Deçanit sipas elaboratit të prezantuar;
6. Marrja e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për vendosjen e tri Trafave në parcelën nr.01999-0, Zk Deçan;
7. Marrja e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Implementimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes Komunës së Deçanit dhe OJQ "Green Art Center -Prishtina"(GAC);
8. Shqyrtimi i kërkesave;
9. Të ndryshme.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri pa vërejtje.

2.Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes "Higjiena",

Pas prezentimit të kësaj pike nga kryesuesi i KPF-së, Anëtarët e KPF-së në përbërje të plotë e kanë shqyrtuar raportin e Ndërmarrjes Higjiena, ku ka qenë i pranishëm edhe Kryeshefi Ekzekutiv i Ndermarrjes, Kastriot Hulaj. Kryesisht pyetjet e anëtarëve të KPF-së janë drejtuar për shpenzimet e ndërmarrjes siç janë: shpenzimet jo materiale, shpenzimet e jashtme profesionale, shpenzimet e automjeteve, shpenzimet e autogomave, është kërkuar sqarim për mjetet financiare që janë nda me vendim të kuvendit për Ndërmarrjen Higjiena, borgjet që ka trashëgu ndërmarrja, borgjet aktuale që ka ndërmarrja, punësimet në ndërmarrje dhe zhvillimi i procedurave të punësimit si dhe a i ka gjete ne ndërmarrje ata punëtor apo janë punësuar pas marrjes së detyrës nga kryeshefi, Kastriot Hulaj, është kërkuar sqarim edhe për servisim të automjeteve të ndërmarrjes se a behen në servisim ku i ben komuna apo kane të kontraktuar servis tjetër.

Kryeshefi Ekzekutiv i Ndermarrjes "Higjiena" Kastriot Hulaj, ka dhene sqarime për të gjitha pyetjet e ngritura në hollësi, duke sqaruar si behen shpenzimet dhe si janë ndare në kategori të ndryshme, poashtu ai ka njoftuar edhe për mjetet që janë marre me vendim të Kuvendit-ne total shuma prej 137.000 € gjate vitit 2020, për punëtorë ka thënë se i ka gjete të punësuar në ndërmarrje, dhe krejt në

fund është kërkuar nga kryeshefi që ne mbledhjen e Asamblese të dt.30.04.21, të bjen si dëshmi faturën që ka paguar borgje në Deponinë në Sferkë të Gashit shuma prej 18.000 € e ndare me vendim të kuvendit të dt.18 dhjetor 2020.Ne mbledhje të kuvendit duhet të prezantohet kjo faturë nga kryeshefi për 18.000 € që i ka nda kuvendi.Raporti përcillet për shqyrtim në kuvend.

3. Shqyrtimi i Raportit financiarë janar-mars 2021.

Kryesuesi e ka prezentu piken. Antarët e KPF-së e shqyrtuan këtë raport dhe shtruan një varg pyetjesh, dhe bënë një varg kritika për shpenzimet e bëra në tre muajt e parë të këtij viti. Vërejtjeve dhe kritikave u është përgjigjur drejtori i buxhetit duke dhënë sqarime për çdo njëri prej tyre, poashtu drejtori ka njoftuar se është rritë inkasimi i tatimit në prone, ku për tre muaj janë inkasuar 162.000 € dhe kjo ka ndodhur falë flet kujtesave të fundit që janë kemi dërgu borgjilive të tatimit në prone ku janë njoftuar që nëse nuk i kryejnë obligimet e tatimit në prone, komuna do të dërgon lëndet në përmbarim.Mon Selmonaj edhe anëtarët tjerë të KPF-se mes tjerash kanë bërë vërejtje edhe për cilësinë e dobët të asfaltit të shtruar në rrugë, për të cilën është kërkuar që në kuvend drejtori, Izet Zenuni, të ep sqarime, poashtu në asamble drejtori i buxhetit do të sjellë edhe specifikacionin e një shpenzimi në zyrë të Kuvendit, të kërkuar nga Albësa Cacaj.Raporti i shpenzimeve përcillet në kuvend për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për Njësinë e administrimit të dokumenteve dhe punën në zyrë; Kryesuesi i kuvendit e ka prezentu projekt rregulloren pastaj për sqarime fjalën ia ka dhënë drejtorit të Administratës. KPF pas shqyrtimit të projekt-rregullores dhe sqarimeve të dhëna nga drejtori, Jashar Dobraj, e kanë vlerësuar si një rregullore e mirë, vetëm kanë kërkuar të zbatohet, si të tillë e përcjellin për shqyrtim dhe miratim në kuvend pa ndryshime.

5. Shpallja me interes e Hapësirave Zhvillimore në Parkun Kombëtar në Komunën e Deçanit sipas elaboratit të prezantuar.

Kryesuesi e ka prezentu këtë pikë, KPF e shqyrtuan këtë pikë dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i Urbanizmit, Ramë Melaj, për rëndësinë që ka marrja e këtij vendimi ku për qëllim ka zhvillimin ekonomik të komunës së Deçanit, në këtë elaborat të prezantuar përfshihen mbi 700 hektar tokë që të gjithë gjenden në Parkun kombëtar Bjeshkët e Nemura.KPF e vlerësojnë si material të mirë, të gjitha pronat që kërkohej të shpallen me interes i vlerësuar të rëndësishme duke e veçuar Bjeshkën e Belegut.

KPF e përcjellin njëzëri për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

6. Shqyrtimi i propozimit për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për vendosjen e tri Trafëve në parcelën nr.01999-0, Zk Deçan.

Kryesuesi e prezentoj piken, KPF e kanë shqyrtuar edhe këtë pikë, ata kanë kërkuar sqarim se çka fiton komuna në rastin e dhënies së pronës kompanisë KEDS-it kur dihet se ajo është kompani private dhe në po i japim prone.KPF i rekomandojnë kuvendit që kompanisë KEDS t'ia japin në shfrytëzim pronën me kompenzim nga 1 euro m² në muaj në kohëzgjatje prej 40 vite, propozim i cili është në harmoni me ligjin në fuqi.Me këtë propozim përcillet në kuvend.

7. Shqyrtimi i propozimit për ndarjen e mjeteve financiare për Implementimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes Komunës së Deçanit dhe OJQ "Green Art Center –Prishtina"(GAC).

Rekomandim-KPF e kanë shqyrtu propozimin dhe kanë kërkuar që të arsyetohet fakti që komuna po ja ep një OJQ-je 80.000 €, për të cilën ka sqaruar drejtori i buxhetit.

Natyrë Kuçi ka qenë kategorik për të rekomanduar asamblesë që kjo pikë mos të shqyrtohet fare, në fund me 4 vota pro, 2 kundër dhe një abstenim, kjo pikë kalon për shqyrtim në kuvend, atje do të ipej prap sqarime.

8. Shqyrtimi i kërkesave;

1.Kërkesa e Klubit të Shahut "Zeqë Hasaj" për përkrahje financiare-2500 €,

2.Kërkesa e Klubit të Hendbollit Femrat "Jusuf Gërvalla"-11,050 €.

Kryesuesi i propozon kërkesat financiare të 2 klubeve sportive, pastaj ka propozuar që këto dy kërkesa të specifikohen edhe pak, të jenë pak më reale në paraqitjen e tyre dhe të vijnë prap.

_Shtyhen dy kërkesat.

3.Kërkesa e paraqitur nga Shkelzen Hadergjoniq-anaj i Asamblesë, për përkatje financiare për ta ndihmuar ne ndërtimin e shtëpisë Shkelzen Mataj nga fshati Baballoq, invalid i luftës, shuma 5000€. Kryesuesi- e paraqiti kërkesën, pas nje debati te zhvilluar ne KPF, kërkesa miratohet. Shkelzen Mataj nga fshati Baballoq perkrahet me 5000 € per ta ndihmuar ne ndërtimin e shtëpisë.

4.Kërkesa e Sindikates se pavarur te shërbyesve civil te Komunes se Deçanit per gjetjen e zgjidhjes financiare per zbatimin e Vendimit te kuvendit per pagesën e shujtës se Nëpunësve civil, ne shumen prej 69,168.00 €. Pas debatit te zhvilluar KPF e përcjellin ne kuvend kërkesën atje debatohet per mundësinë e gjetjes se mundësisë per zbatimin e vendimit te kuvendit per kompenzimin e shujtës së shërbyesve civil te komunës, si dokument shtese kërkohet te prezantohet ne kuvend lista e puntorve te komunës.Kërkesa përcillet në Kuvend për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

Vendime te Kuvendit per Rishqyrtim me kërkesën e MPL:

1.Rishpallja e pronave me interes, per nevojat e rregullimit te shtratit te lumit –Lumbardh i Deçanit, vendim i kuvendit i dt.30.11.2020, i cili kërkon edhe nje here votim ne kuvend dhe marrje te vendimit, për arsye që tri prona atëherë ishin në hipotekë ndërsa tani janë larguar nga hipoteka.

2.Rishqyrtim i vendimit për dhënie te pronës komunale ne shfrytëzim afatgjate, si dhe Formimi i Komisionit vlerësues per dhënie te këtyre pronave ne shfrytëzim, vendim i dt. 30.10.2020, i cili duhet te votohet edhe nje here ne kuvend sepse kur eshte marre vendimi nuk e kemi plotesuar kriterin e shpalljes se listës se pronave qe planifikohen te ipen ne shfrytëzim ne vitin pasues.


3.Rishqyrtim i Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale KEDS-it për vendosjen e Stabilimentit shpërndarës në fshatin Irzniq, për degëzimin e rrjetit elektrik për fshatratë Ratishë, Glllogjan, Shaptej etj, vendim i dt.08.04.2021.

Edhe ky vendim duhet te votohet edhe nje here ne Kuvend sepse Vendimi duhet te harmonizohet me legjislacionin në fuqi, si dhe duhet te caktohet çmimi I dhënies në shfrytëzim sepse ligji nuk e lejon dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë pa kompenzim, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm nuk mund të jepet pa kompenzim. KPF I rekomandon kuvendit 1 euro ne muaj per m².

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni



Verifikon procesverbalin



Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj





Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.IV

Deçan, dt.27.05.2021

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së, me dt.27.05.2021.

Në mbledhje merrnin pjesë: 7 anëtar të KPF-së, drejtori i Buxhetit-Agron Demukaj, Drejtori i BPZHR-Rifat Stojkaj, Zyrtarja për informim-Yllarta Thaqi,

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte për bashkëfinancim me CHWB Kosova, në projektin "Muzealizimi i Kullës-Muze të Dëshmorëve në Gllogjan-shuma 24,500 €;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për BPZHR për ndarjen e mjeteve financiare për hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes në bashkë-financim me K.R.U."Drini i Bardhë";
5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcela nr.1294-1 Zk Deçan;
6. Shqyrtimi i kërkesave;
7. Të ndryshme.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri pa vërejtje.

1. Shqyrtimi i Qarkores së parë buxhetore.

Rekomandim:KPF e shqyrtuan Qarkoren e parë buxhetore, për të cilën ka sqaruar drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Agron Demukaj, ku sipas tij shqetësuese për ne edhe këtu është minusi të buxheti i arsimit dhe shuma e lartë e inkasimit të hyrave vetanake të përcaktuara me Qarkore. Albasa Cacaj- ka pyetur sa a ka bere komuna plan për arsim që të mos na paraqitet çdo vit problemi i njëjti ku një prej masave është mos të hapet konkurs për puntorë që dalin në pension, ndërsa për të hyra që ka caktuar Ministria inkasimin e një shume kaq të madhe a kini kini masa ju si komune për evitimin e pasojave nga mos realizimi i shumës së caktuar të hyrave.Drejtori i buxhetit përgjigjet se për Arsim e kemi strategjinë e arsimit ndërsa për mos realizim të inkasimit të hyrave mbesin pa u realizu projektet në mungesë të buxhetit.Valdet Nuraj thotë se të zëvendësimi i puntorëve të arsimit janë disa profile të arsimit të cilët nuk mund të bëhet zëvendësim.KPF e përcjellin për shqyrtim në kuvend Qarkoren, atje do të caktohen datat kurë do të mbahen debatet publike për Qarkoren e parë Buxhetore.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sporte për bashkëfinancim me CHWB Kosova, në projektin "Muzealizimi i Kullës-Muze të Dëshmorëve në Gllogjan-shuma 24,500 €.

Rekomandim:Drejtoresha e Kultures, Leonora Ukëhajdaraj, ka njoftuar se që një vit jemi duke punuar me kompaninë mirëpo në fund ka deshtu marrëveshja, ata nuk do të investojnë me buxhet

eshte bere përzgjedhja e kullave per renovim, per te cilën drejtoresha eshte përgjigje se jemi vonuar me procedura, ndërsa per përzgjedhje jemi shku neper te gjitha fshatrat dhe i kemi përzgjedhë ato ma te nevojshmet, ndërsa Kompania i ka përzgjedhë ato Kulla qe kane kerku ma pak investime.Valdet Nuraj per Kullen ne Glllogjan thot se eshte papergjigjsi totale qe tri vjet tuj u marre me ate qeshtje sepse ishte dashtë me u kry deri tash, ne vazhdim ai ka bere vërejtje ne formën e kërkesës me te dhënat e paraqitura aty si dhe ka shprehe keqardhje qe Kulla ne Gllloogjan ka mbete ne ate gjendje, poashtu edhe Kulla e Deshmorve nuk e ka as nje broshure qe ju ndihmon vizitorve.Kushtrim Loshaj pyet se çka do te behet me kete kerkese dhe sa kemi mundsi ne me mjete tona ta realizojmë.Kryesuesi ka thene se Kulla rinovohet me faza dhe per kete sqaroj edhe drejtoresha,Drejtori buxhetit thot qe nëse nuk bashkefinancojne ata si kompani na me Rishikim te buxhetit e ndajmë mjetet as sa nevoiten per përmbushje te projektit.Valdet Nuraj thot se ka vërejtje shum per 27.000 € dhe sipas materialit te prezentuar nuk eshte e arsyeshme me nda mjete per ato qe përcaktohet ne marrëveshje.Drejtoresha ka dhene sqarime te hollsishme per çdo qeshtje te ngritur. KPF e kanë shqyrtuar kete kerkese, ata janë shprehur se janë për miratimin e saj, mirëpo meqenëse ka dështuar marrëveshja me CHWB Kosova, KPF Rekomandon qe kjo pike te hiqet nga rendi i ditës se mbledhjes se Asamblese dhe të miratohet me Rishikim të buxhetit me fonde tona vetanake.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për BPZHR për ndarjen e mjeteve financiare për hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes në bashkë-financim me K.R.U."Drini i Bardhë".

Rekomandim: Pas prezentimit te pikës nga kryesuesi i KPF-se, sqarime ka dhene drejtori i drejtorisë per BPZHR per arsyeshmerine e kësaj kerkese.Albana Avdiu ka pyet drejtorin qe a e kini dite ju si drejtori qe Ndermarrja Higjiena eshte kah e bene hapjen dhe rekonstruimin e kanaleve.Drejtori sqaron se ligjërisht kompetent per hapje te kanaleve janë Kompania Drini i Bardhe si dhe fakti qe mund ti ndihmojmë fermerët eshte e mirëseardhur.Albana Avdiu thot se kete pune e bene ndërmarrja Higjiena dhe eshte mire qe këto pune me ja dhanë kësaj ndermarrjeValdet Nuraj pyet nëse na i ndajmë këto mjete a kan me pagu fermerët per taksa vjetore per ujitje te tokës.Drejtori pergjigjet se fermerët asnjë cent nuk e paguajnë.Valdet Nuraj pyet se a ka betonu naj kanal kjo kompani tri vitet e fundit, te Drini i Bardhe disa here e kemi ba nje kerkese per hapjen e nje kanali qe lidhet me projektin Vija e gështenjës dhe nuk eshte kry si dhe kush na garanton se se vjen uji deri ne Sterllc.Drejtori pergjigjet se Kompania Hidro Drini eshte Regjionale dhe ne nuk kemi kurrfarë kontrolli mbi te, pastaj ka sqaruar edhe per angazhimet qe ka ba si drejtor i drejtorisë ne kete drejtim.Albana Avdiu pyet a ka interevnu naj here Drini Bardhe vet pa kerkese..Drejtori thot se per vërshime kan intervenu pa kerkese vet.Albesa Cacaj pyet sa janë te knaqr fermerët me me punën e kësaj kompanie, si dhe pajtohem me Albanen qe paret te mbesin ne Deçan mos te shkojnë jasht Deçani, ndërsa vitin e kaluar janë hape kanalet por uj nuk ka pase me ujite dhe a pkerkoni llogaridhënie ndaj kompanisë per te metat qe paraqiten gjate rrugës se implementimit te projektit.Drejtori pergjigjet se ekzistojnë te gjitha shqetësimet e juaja , na jemi mundu me ardhe deri te ndarja e deri te marrëveshja , ne po mundohemi per te mirën e qytetarve tone, na nuk mund ti kontrollojmë ata si kompani.Kushtrim Loshaj parimisht jam per me ju ndihmu fermerve , kishte qene mire qe ne te ardhmen këto pune me i bo Ndermarrja Higjiena sepse kjo pune e hapjes se kanaleve mund te fute si pune te Kontarta ne shpi. Drejtori thot se si ide eshte e mire , per vitin tjetër eshte mire mu bo ashtu. Valdet Nuraj ka pyet drejtorin, a ki plan strategjik sa km. Kanale duhet te hapen , se psh ne fshatin Strellc nuk i ki planifiku me hapë. Drejtori thot se ne si drejtori i bëjmë kërkesat sipas nevojës per çdo kanal dhe kompania duhet me i hape sipas kërkesës tone.Valdet Nuraj thot se une jam per me u hape kanalet e ujitjes por kategorikisht jam kundër Drenit të Bardhë, me jau dhanë atyre kete pune sepse janë shum te papërgjegjshëm.Kryesuesi ka thene se qëllimi i komunës eshte i mire sepse mendojnë qe ti lirojnë fermerët nga taksa vjetore e pagimit te ujit per ujitje qe eshte 50 euro per hektar, ne vazhdim e qiti ne votim, antaret e KPF-se njëzëri e përcjellin per shqyrtim dhe miratim ne kuvend kërkesën e drejtoris per BPZHR per ndarjen e 16.500 euro per hapjen dhe mirëmbajtjen e kanaleve te ujitjes.KPF e shqyrtuan kërkesën e Drejtorisë për BPZHR dhe janë

zhvilluar e kanë përcjellë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, në shumën prej 16.000 €.

5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për miratimin e Vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës- parcela nr.1294-1 Zk Deçan;

Rekomandim:KPF e përcjellin per kuvend me kusht që në Kuvend të vjen personi përgjegjës me dhanë sqarime.

6.Shqyrtimi i kërkesave.

1. Kërkesa e Kryetarit të Komitetit të Komuniteteve për ndërtim të shtëpisë së familjes minoritar Qekiqaj. Pas debatit të zhvilluar KPF pajtohet që ta ndihmojnë këtë familje dhe familjet tjera me nevojë, mirëpo meqenëse për momentin nuk kemi buxhet të dedikuar për këto raste, do të shikohet me Rishikim të buxhetit si dhe duhet të ripërtërihet Marreveshja me Jetimat e Ballkanit për bashkparticipim në ndërtimin e shtëpive të familjeve me nevojë, me këtë rekomandim del në Kuvend për shqyrtim dhe marrje të vendimit.

2.Kërkesa e tri Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së.

Rekomandim:KPF pas shqyrtimit të kërkesës i rekomandojnë Kuvendit që të merr vendim për përkrahje financiare të tri Shoqtave të dala nga lufta në shumën totale prej 15.000 €, me kete ndarje:

-Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Deçan(OVL) -10.000 €.

-.Shoqata e Invalidëve-3500 €.

-.Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve-1.500 €.

3.Kërkesa e Shpejtim Ahmetaj për përkrahje financiare për organizimin e Turnirit “May Tay” të karakterit Nderkombëtar, i cili është mbajtur në pejë por tash e tutje do të mbahet në Deçan , me emrin e patriotit Smajl Haradinaj, turniri do të mbahet me 16 Qershor –Dita e Çlirimit të Deçanit. Drejtoresha e Kultures ka njoftu se kërkesa është për 6500 euro mirëpo Federata do ta perkrahe me 2500 euro ndërsa nga komuna kërkohen 4000 euro. Miratohen njëzëri 4000 euro.

4.kerkesa per pagimin e faturës se drekës te organizuar me dt.5 maj –Diten e Deshmoreve te Deçanit per familjaet e deshmorve ne restorantin 4 Yjet, shuma e fature 4200 euro. Miratohet njëzëri.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lllolluni

Verifikon proses verbalin



Kryesuesi i KPF-së
Haki Shehaj